



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 24.4.2023

Nr: 404

Ora: 16:00

VENDIM

PËR

**CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARIN E TRETË DHE TË KATËRT
TË GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenit 95, pika 2, nenit 96, pika 1, si dhe nenit 183, pika 8 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi relacionin bashkëlidhur këtij vendimi dhe pasi dëgjoi përfaqësuesit e partive politike në KQZ,

V E N D O S:

1. Partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të Grupeve të Numërimit të Votave është Partia Socialiste e Shqipërisë.
2. Partitë politike të opozitës parlamentare, që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, në bazë të rezultatit të shortit, janë:
 - a) Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet,
 - b) Partia e Lirisë.
3. Shorti zhvillohet me datë 24.4.2023 ora 12:00.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 24.4.2023 Nr: 404
Ora: 16:00



“Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”